

## Procesverbal

I hartuar më 18.05.2021 në debatin me banor ne fshatin Orllan, ku ishin te ftuare edhe banoret e fshatrave Barainë, Kushevicë, Brainë, Metergoc, Kalaticë, Bërvenik, Bllatë, Rakinicë, Turuqicë dhe Muhazob.

Temë diskutimi ishte; Propozim Rregullorja per organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Podujevës.

Drejtori i Administratës në komunën e Podujevës Bahri Selimi i cili edhe u drejtoi debatin, i informoi të pranishmit mbi të gjitha procedurat e kësaj propozim rregulloreje, e cila është hartuar në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 mbi organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Në bazë të këtij udhëzimi administrativ komuna e Podujevës duhet ti formoi 30 këshilla lokale. Me propozim rregulloren komunale është paraparë që 24 këshilla lokale të formohen nëpër fshatra dhe 6 ne qytet. Këto janë vetëm propozime dhe pas debateve dhe propozimeve dhe kërkesave banorëve mund të ndryshohen.

Kjo propozim rregullore qysh ne vitin 2020 ka dal ne diskutim publik por për shkak pandemisë kovid 19 është shtyrë, po ashtu edhe ne vitin 2021 nga asambleja komuna është shtyrë për një kohe ma te përshtatshme. Në mbledhjen e fundit asambleja komunale e ka qit në diskutim publik.

Mehmet Arifi nga fshati Barainë kërkoji që fshati Barainë të ti bashkohet këshillit të fshati Orllan si ka qenë deri më tani e jo të jetë me këshillin e fshatit Batllavë.

Nushi Selimi nga fshati Orllan dha vrenjtje se nuk kemi qenë të informuar për këtë projekt rregullore dhe për ndarjen e fshatrave ne këshilla lokale. Ka qenë dashtë të vendosen disa lajmërimë nëpër qendrat e fshatrave.

Milazim Haliti pyeti se si është e mundur që kryetari i këshillit lokal të Batllavës ta përfaqësoi fshatin Barainë.

Latif Mehmeti theksoj se ndarja e 30 këshillave lokale për komunën e Podujevës është bërë ne bazë të regjistrimit të popullsisë. Mendoj se në Bërvenik nuk ka nevojë për këshill lokal sepse vetëm 24 familje jetojnë ne këto fshatra të propozuar për këshill lokal ne Bërvenik. Prandaj propozoi që vetën ne Orllan të formohet këshilli lokal, ku 11 fshatra kanë 142 familje. Nuk po ka mundsi që fshatrat me 300 familje te kenë këshillin e vetë lokal.

Bahri Selmi - kjo projekt rregullore ka mundësi me i ndryshua këshillat e fshatrave, për këtë arsye janë duke u mbajte këto takime me banoret e fshatareve dhe lagjeve.

Rexhep Zeka nga shoqëria civile tha se duhet zbatuar udhëzimin administrativë, dhe përkrahu propozimin e latif mehemit që në vetëm Orllani te këtë këshill lokale, dhe kërkoi qe te sigurohen hapësira për zyrat lokale . Po ashtu propozoi në nenin 9 të ndryshohet pika 7 ku afati prej 30 ditësh i përgjigjejës te zëvendësohet me 10 ditë. Po ashtu propozoi që në përzgjedhjen e projekteve të jetë një anëtar i këshillit lokal nga lokaliteti që është projekti.

Bahri Selimi tha se afati prej 30 ditësh është i përcaktuar me ligj. Sa i përket prezencës të natarëve të komuniteteve në hapjen dhe implementimin e projekteve ka mundësi edhe tani, kjo qeshje është e lehtë.

Bahri Selimi tha i kuptoi se nuk do të jetë e lehtë formimi i këshillave lokale, duke pas parasysh numrin e madh të fshatrave dhe pozitën gjeografike te komunës së Podujevës.

Do të kërkoi takim me ministrin e pushtetit lokale, do të ia paraqes të gjitha kërkesat e komunitete neper këto debate dhe do te kërkoj nga ministri ndryshimin e udhëzimet administrativ.

Orllan,

Më 18,05,2021

Procesmbajtësi

Latif Mehmeti